



## **NE EMER TE POPULLIT**

**Gjykata Themelore në Gjilan Dega në Novobërdë-Departamenti i prgjithshëm**, përmes gjyqtarit Hasan Sadiku, me sekretaren juridike Emine Shkaodra, në lëndën penale kundër të akuzuarit **Miruz M.**, nga fsh. **K...**, Komuna e Novobërdës, të cilin e mbrojnë av. **D...** nga Gjilani, për shkak të veprës penale në vazhdimësi lidhje e paautorizuar në shërbime nga neni 321 lidhur me nenin 81 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokuroris Themelore në Gjilane, PP.II.nr. 948/2017 të datës 09.06.2017, të cilën e ka përfaqësuar prokurorja Leonora Shemsiu-Kadriu, pas mbajtës së seancës për shqyrtimin e marrveshtjes për parnimin e fajsisë në prezencën e prokurores së shtetit, të akuzuarit dhe mbrojtës së tij me datë 30.10.2017 mori dhe publikisht shpalli këtë.

## **A K T G J Y K I M**

I akuzuari **Miruz M.**, pa pseudonim dhe emër të rrejshëm, nga i ati **A...**, dhe e ëma **Sh...**, e lindur **G...**, i lindur më 10.05.1953 në fsh. **B...**, tani me vendbanim në fsh. **K...**, ka të kryer shkollën fillore, shqipëtar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind i pesë femiu, i gjendjes së varfur ekonomike, jeton nga asistenca sociale, i pa dënuar deri më tani, për veprë penale, dhe nuk zhvillohet ndonji procedurë për veprë tjetër penale,

## **është fajtor**

Sepse nga koha e pavërtetuar më parë e deri me datë 12.12.2016, në shtëpinë e tij në fsh. **K...**, Komuna e Novobërdës, si konsumator i energjis ekektrike me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vehte, është lidhur në mënyrë të paautorizuar në rrjetin e emergjis elektrike në kundërshtim me ligjin, për energjin elektrike, në atë mënyrë pas vërtetimit të gjendje faktike, tek shtëpia e të akuzuarit, nga ekipi kontrollues i **...**-it, është konstatuar gjendje e pa rregullt, ku i akuzuari në mënyrë të paautorizuar përmes një koblloje, jashtë pikës matëse, është lidhur në rrjetin e emergjis

elektrike duke bërë lidhjen direkte, ashtu që energjia elektrike e shpenzuar përmes lidhjes direkte në rrjetin elektrik nuk është llogaritur, dhe në këtë mënyrë i akuzuari me veprimet e veta të kundërligjshme në vazhdimësi ka shpenzuar energji elektrike të pa faturuar nga kjo lidhje direkte e paautorizuar, e ka dëmtuar I [redacted], [redacted] në Gjilan, për shumën prej 532,14 euro.

Me qka ka kryer veprën penale, në vazhdim lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 lidhur me nenin 81. të KPRK-se

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 41, 45, 46, 47, 73, 74, 75 dhe 76 të KPRK-së, lidhur me nenin 365 të KPPRK-së,

## E G J Y K O N

Me gjobë në shumë prej 200(dy qindë) euro dhe me dënim me burg në kohë zgjatje prej 60(gjashtë dhjetë) ditësh e të cilat dënime nuk kanë për tu ekzekutuar në qofteëse i akuzuari brenda afatit prej 1(nji) viti pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonji vepër tjetër penale, në të kundërtën ky vendim do të revokohet.

I akuzuari obligohet që ti kompenzoj të gjitha shpenzimet e procedurës penale si dhe paushallin gjyqësor në shumë orej 20 euro.

I dëmtuari KEDS-si, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontestin civil.

## A r s y e t i m

### **1.Ecuria e procedurës**

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur akuzën, PP.II.nr. 948/2017, të datës 09.06.2017, kundër të akuzuarit M [redacted], M [redacted], nga fsh. Kl. [redacted], për shkak të vepraës lidhja e paautorizuar nga neni 321 lidhur me nenin 81 të KPRK-se,

Pas ngritjes së aktakuzës palët me dat. 09.06.2017 kanë arritur marrveshje për pranimin e fajsis e cila është deponuar në gjykat me dat. 16.05 2017 e lidhur në mes të Prokuroris Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm, në njërën anë, si dhe mbrojtëses së të akuzuarit dhe të akuzuarit



në naën tjetër. Sipas kësaj marrveshje gjykatës i është rekomanduar që ndaj të akuzuarit *Mirza Malaj* për shkak të veprës penale të lartë cekur ti shqiptohet demimi me gjobë në shumë prej 200(dy qindë) euro dhe dënimi me burg në kohë zgjatje prej 60 (gjashtë dhjetë) ditëve, e të cilat dënime nuk kanë për ta mbajtur në qoftëse i akuzuari në afat prej 1(nji) viti pas plotfuqishmërisë së këtij akugjykimi, nuk kryen ndonji vepër tjetër penale, në të kundërtën ky vendim do të revokohet.

## **2. Vlerësimi i marrveshjes për pranimin e fajsisë**

Në shqyrtimin gjyqsor të mbajtur me datë 30.10.2017, gjyqtari i vetëm pas dëgjimit të palëve dhe atë dhe atë Prokurorës së Shtetit, mbrojtësës së të akuzuarit dhe të akuzuarit e ka pranuar marrveshtjen për pranimin e fajsisë, nga se ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari ka konstatuar se i akuzuari *Mirza Malaj*, e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajsisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pas konsultimeve me mbrojtësën e tij, se i akuzuari nuk ka qenë i shtrënguar që ta pranojë fajësinë, dhe se pranimi i fajit ka mbështetur në faktet që i përmban aktakuzën dhe se nuk ekziston asnjë rrethanë e parapar me nenin 253 par. 1 të KPPK-ës.

## **3. Gjendja faktike e vërtetuar**

Andaj, duke u bazuar në të cekurat më lart gjyqtari ka vërtetuar këtë gjendje faktike: Se i akuzuari *Mirza Malaj*, e ka kryer vepraën penale në vazhdim lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 lidhur me nenin 81 të KPRK-ës, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij akugjykimi.

## **4. Elementet e veprës penale**

Gjyqtari pas dëgjimit të palëve lidhur me dënimin, e shpalli fajtor të akuzuarin *Mirza Malaj*, për shkak të veprës penale lidhja e paautorizuar në shërbime nga neni 321 lidhur me nenin 81 të KPRK-ës, nga se në veprimet e tija manifestohen të gjitha tiparet kësaj vepre penale të këtyre dhe se për të njëjtën edhe është penalisht përgjegjës.

## **5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit**

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit, i ka vlersuar se duhet aprovohet rekomandimi i paraqitur në marrveshje për pranimin e fajsisë që

ndaj të akuzuarit M. ... M. ..., ti shqiptohet dënimi me dhobë në shumë prej 200 (dyqindë) euro dhe dënimi me burgim në kohë zgjatje prej 60 ditëve, i kushtëzuar për 1 (nji) vit, me bindje se ky dënim i shqiptuar është në harmoni të plotë me peshën e veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata mor për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në lartësinë e dënimit të parapara me nenin 73 të KPRK-ës. Kështu si rretanë lehtësuese ia mori faktin se ka arritur marrëveshtjen me Prokurorin e shtetit për pranimin e fajsisë, pra i akuzuari ka bashkëpunuar me prokurorin e shtetit, ka shprehur keqëardhje dhe është penduar për kryerjen e kësaj vepre penale, dhe se ka premtuar se në të ardhmën nuk do të kryej vepra tjera penale, gjendjen ekonomiko sociale se i njëjti jeton nga asistenca sociale, dhe se të gjitha këto rrethana tregojnë se edhe me një dënim të tillë të butë mundë arrihet qëllimi i dënimit dhe nga i akuzuari mund të pritët që në të ardhmën nuk do të kryej ndonji vepër tjetër penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në dispozitën e nenit 453 par. 1 të KPPK-ës.

Vendimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike është i bazuar në dispozitën e nenit 463 par.1 të KPPK-ës.


Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitivë të aktgjykimit.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - DEGA NË NOVOBËDË –**

*Departamenti Përgjithshëm*

**P.nr.38/2017, më 30.11.2017.**

Sekretarja juridike,  
Emine Shkodra,



Gjyqtari  
Hasan Sadiku

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Pishinë, në afat prej 15. ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi. Ankesa dorzohet përmes kësaj gjykate.